

## VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Ardian Dvorani	Anëtar
Andi Çeliku	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Medi Bici	Anëtar

Mori në shqyrtim në seancë gjyqësore të datës 26.09.2017, çështjen që i përket:

**PADITËS:** **Tatjana Malaj**

**PADITUR:** **Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Fier**

**OBJEKTI:**

1. Detyrimin e palës së paditur ta dëmshpërblejë me 2 paga mujore, për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.
2. Detyrimin e palës së paditur ta dëmshpërblejë me 3 paga mujore, për mosrespektim të afateve të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.
3. Detyrimin e palës së paditur ta dëmshpërblejë me 12 paga mujore, për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.
4. Detyrimin e palës së paditur ta dëmshpërblejë për vjetërsi në punë, sipas librezës së punës.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 143, 144, 145, 155 të Kodit të Punës, neni 32 dhe 154 i K.Pr.Civile

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**, me vendimin nr. 1589 (62-2012-4992), datë 26.07.2012 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të padisë së palës paditëse Tatjana Malaj, ndaj palës së paditur Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Fier.

Detyrimin e palës së paditur Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Fier, të dëmshpërblejë palën paditëse Tatjana Malaj, me pagën e 5 (pesë) muajve, për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës, në mënyrë të menjëhershme, pa shkaqe të arsyeshme.

Detyrimin e palës së paditur Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Fier, të dëmshpërblejë palën paditëse Tatjana Malaj, me 10 (dhjetë) paga mujore, për shkak të vjetërsisë në punë.

Pranimin e padisë, për kërkimet e tjera.

**Gjykata e Apelit Vlorë**, me vendimin nr. 597, datë 08.04.2014 ka vendosur:

Lënien në fuqi të Vendimit nr. 1589 (62-2012-4992), datë 26.07.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për sa i përket shpërbimit për vjetërsi në punë si dhe për pjesën që ka rrëzuar padinë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës, si dhe për shpenzimet gjyqësore.

Ndryshimin e vendimit për pjesën tjetër në këtë mënyrë:

Detyrimin e të paditurit D. R. Shëndetësisë Fier, të dëmshpërblejë paditësen Tatjana Malaj me 12 paga mujore për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës, si dhe me 3 paga mujore për mosrespektim të afatit të zgjidhjes së kontratës së punës.

\*\*\*

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në mbështetje të shkronjës “c” të nenit 63 të ligjit nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*,

#### **V E N D O S I:**

Prishjen e vendimit nr. 597, datë 08.04.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Tiranë, më 26.09.2017

**Nr. 31003-02094-00- 2014 i Regj. Themeltar  
Nr. 00 - 2017- 1542 i Vendimit ( 783)**